



Mihallaq Qirjo Prof. Asociuar

Mihallaq Qirjo ka përfunduar studimet universitare në UT, Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Degën e Biologjisë, dhe ka formimin mjedisor duke marrë gradën Doktor i Shkencave në fushën e Ekologjisë së Aplikuar. Është pedagog i lëndëve të Ekologjisë dhe Ekologjisë së Ekosistemeve në disa fakultete të Universitetit të Tiranës. Fushat e kërkimit shkencor lidhen me ekosistemet, dinamikën e popullatave dhe biodiversitetin. Gjithashtu, drejton kurset e Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm në disa Programe Studimi Master të Mësuesisë, si trajner i certifikuar për kualifikimin e mësuesve në këtë fushë.

I përfshirë në lëvizjen mjedisore që në vitin 1992, ka drejtuar një sërë programesh mjedisore në nivel kombëtar dhe rajonal për politikën mjedisore për ndryshimet klimatike, menaxhimin e mbetjeve, të burimeve natyrore, etj, përfshirë zhvillimin institucional, pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen mjedisore dhe ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile. Ka marrë pjesë në programe të kërkimit dhe shkëmbimit shkencor me shumë vende perëndimore dhe të rajonit.

Ka dhënë kontribut si autor për hartimin e materialeve edukuese të Edukimit Mjedisor si Paketa e Gjelbërt (2006), Paketa e Gjelbërt Junior (2018), Paketa e Ajrit (2015). Ka mbi 30 artikujt dhe botime si rezultat i punës kërkimore shkencore në fushën e ekologjisë, mjedisit dhe edukimit mjedisor.